



**MILLENNIUM  
FOUNDATION  
KOSOVO**



Republika e Kosovës - Republika Kosova  
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica  
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative  
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove

01 Nr./Br. 492/01-15099  
Data/Datum 15.06.2022  
Gjakovë-Djakovica-Gjakova

**Marrëveshje Bashkëfinancimi**

mes

**Fondacionit të Mijëvjeçarit të Kosovës,**

**dhe**

**Komunës së Gjakovës,**

**dhe**

**Shoqata e Pronarëve të Shtëpive (ShP) të MAB "Te Gjykata"**

**Shoqata e Pronarëve të Shtëpive (ShP) të MAB "Rilindja Jonë"**

për

**Rinovimet për Eficiencë në Ndërtesa Shumëbanesore (AER)**

**Data: 8 qershor, 2022**

Kjo Marrëveshje Bashkëfinancimi lidhet nga dhe ndërmjet:

1. **Fondacionit të Mijëvjeçarit të Kosovës ("MFK")**, fondacion vendor i organizuar dhe regjistruar në përputhje me Marrëveshjen për Grant të Programit Threshold të Sfidës së Mijëvjeçarit të nënshkruar dhe ratifikuar më 12 shtator 2017, ndërmjet Republikës së Kosovës, të përfaqësuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës ("Qeveria"), dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të përfaqësuar nga Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit ("MCC");
2. **Komuna e Gjakovës ("Komuna")**;
3. **Shoqata e pronarëve të shtëpive (ShP) i MAB "Te Gjukata" ("ShP Gjukata")**;
4. **Shoqata e pronarëve të shtëpive (ShP) i MAB "Rilindja Jonë" ("ShP Rilindja Jonë")**;

Në vijim referohen ndarazi si "MFK", "Komuna", "ShP Te Gjukata" dhe "ShP Rilindja Jonë"

## **I. Lista e shkurtesave**

Në këtë Marrëveshje, shkurtesat e mëposhtme kanë këto kuptime:

**AER**- Rinovimet për Eficiencë në Ndërtesa Shumëbanesore

**MO i AER** - Manuali i Operimit i AER

**PPN** - Plani i Punimeve Ndërtimore

**Kontraktori** - Kompani që merret me punimet ndërtimore, e përzgjedhur nga MFK-ja përmes procedurës së tenderimit

**FN** - Faza e Ndërtimit

**CPP** - Protokolli i Fazës së Ndërtimit

**DAED**- Plani i Detajuar Arkitektonik dhe Inxhinierik

**DSC** - Kompania për Projektim dhe Mbikëqyrje

**EE** – Eficienca e Energjisë

**MEE** - Masat për Eficiencë të Energjisë

**PF** - Plani Financiar

**ShP** – Shoqata e Pronarëve

**KB** – Këshilli i Banorëve

**IC** – Konsulenti Zbatues i PIEE

**MAB** - Ndërtesat banesore për shumë familje

**MCC** – Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit

**MFK** – Fondacioni i Mijëvjeçarit të Kosovës

**MM** – Memorandumi i Mirëkuptimit

**CP** - Certifikata e Pagesës

**PIEE** - Pilot Stimujt për Eficiencë të Energjisë

**RELP** - Projekti "Peizazhi i Energjisë së Qëndrueshme"

**SEEK**- Subvencionet për Eficiencën e Energjisë në Kosovë

**TVSH** –Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

**Punime** -Punimet Ndërtimore për Riparime

## DEKLAMIME

*Duke pasur parasysh që* Qeveria e Kosovës ka themeluar MFK-në si një subjekt autonom me një autoritetet të pavarur ligjor për të mbikëqyrur, menaxhuar dhe zbatuar Programin Threshold, të financuar nga MCC. Programi Threshold me Republikën e Kosovës, do të sigurojë deri në 49 milionë dollar amerikan për mbështetjen e reformave të rëndësishme të politikave për të përmirësuar furnizimin me energji elektrike përmes promovimit të efikasitetit të energjisë dhe gjenerimit të energjisë së ripërtërishme, si dhe për të promovuar qeverisje transparente dhe të përgjegjshme;

*Duke pasur parasysh që* projekti kryesor në kuadër të Programit Threshold është projekti “Peizazhi i Energjisë së Qëndrueshme” (“REL”), i cili synon të zvogëlojë hendekun mes kërkesës dhe furnizimit me energji, duke ulur përdorimin e energjisë përmes pilotimit të investimeve të ekonomive familjare në efikasitetin e energjisë, kalimin në burimet joelektrike të ngrohjes me kosto efektive dhe zvogëlimin e barrierave për hyrjet në treg të prodhuesve të pavarur të energjisë;

*Duke pasur parasysh që* aktiviteti “Pilot Stimujt për Efikasitetin e Energjisë” (PIEE)<sup>1</sup> në kuadër të RELP pritet të kontribuojë drejt objektivit të RELP duke rritur ndërgjegjësimin e konsumatorëve sa i përket masave të kursimit të energjisë dhe përfitimet e tyre, si dhe duke u mundësuar familjeve me të ardhura më të ulëta ta tejkalojnë pamundësinë e pagesës së tyre përmes sigurimit të stimujve. Aktiviteti i PIEE përbëhet prej tri (3) pakove kryesore të intervenimit (PI): (i) Rinovimet për Efikasitetin në Shtëpi Individuale (HER); (ii) Rinovimet për Efikasitetin në Ndërtesa Shumëbanesore (AER), dhe (iii) Gratë Ndërmarrëse në Energji (GNE). Asistenca teknike për MFK-në, në lidhje me zbatimin e PIEE, sigurohet nga Konsulenti Zbatues (“IC”);

*Duke pasur parasysh që* objektiva kryesore e pakos së intervenimit të AER është që të zvogëlohet kërkesa për energji/elektricitet dhe kostove të ndërlidhura në sektorin e banimit; të rritet ndërgjegjësimi i EE në sektorin e banimit; përmirësimi i konkurrencës në tregun e shërbimeve të energjisë në Kosovë; dhe mbështetja e standardeve të EE dhe programeve të stimujve për zhvillimin e mëtejshëm të ndërtesave shumë banesore (MAB);

*Duke pasur parasysh që* Komuna e Gjakovës dhe MFK kanë nënshkruar Memorandumin e dytë të Mirëkuptimit më 19 janar 2021 duke shprehur vullnetin për të bashkëfinancuar zbatimin e masave në lidhje me Rinovimet për Efikasitetin në Ndërtesa Shumëbanesore (AER) në MAB-të e zgjedhura;

*Duke pasur parasysh që,* banorët e MAB të zgjedhur, të përfaqësuar nga by “ShP Te Gjakata” dhe “ShP Rilindja Jonë” shprehën gatishmërinë për ta bashkëfinancuar zbatimin e masave në lidhje me Rinovimet për Efikasitetin në Ndërtesa Shumëbanesore (AER) në MAB-të e tyre të zgjedhura;

*PRANDAJ, TANI,* duke marrë parasysh detyrimet dhe përfitimet nga kjo Marrëveshje, Palët bien dakord reciprokisht si më poshtë:

---

<sup>1</sup>Brendi i ndryshuar në fillim të vitit 2020 në SEEK (Subvencione për Efikasitetin të Energjisë në Kosovë).

## NENI 1

### Zotimi për bashkëfinancim

1.1 Palët e ofrojnë pjesën e tyre të bashkëfinancimit për ta bashkëfinancuar zbatimin e MEE nën AER IP (SEEK) për kompleksin e mëposhtëm të zgjedhur MAB:

- MAB Kompleks “ShP Te Gjykata” dhe “ShP Rilindja Jonë” (4 MABS: “ShP Te Gjykata” dhe “ShP Rilindja Jonë”)

1.2 Palët e ofrojnë pjesën e tyre të bashkëfinancimit si më poshtë:

- **Nën projekti: MAB Kompleksi “ShP Te Gjykata” dhe “ShP Rilindja Jonë”**
  - i. MFK ofron 60% të financimit (shuma në Euro) të kostos totale të nënprojektit, pa TVSH;
  - ii. Komuna e Gjakovës ofron 30% të financimit (shuma në Euro) të kostos totale të nënprojektit plus Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) të aplikuar në këtë shumë.
  - iii. “ShP Te Gjykata” dhe “ShP Rilindja Jonë”, ofrojnë 10% të financimit (shuma në Euro) e llogaritur si kosto totale e MAB Kompleksit së tyre përfaqësues “ShP Te Gjykata” dhe “ShP Rilindja Jonë”, plus Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) të aplikuar për këtë shumë.

## NENI 2

### Transferimi dhe menaxhimi i fondeve

- 2.1 Fondet e Komunës dhe Fondet e “ShP Te Gjykata” dhe “ShP Rilindja Jonë” mbahen dhe administrohen nga MFK.
- 2.2 Fondet e përmendura në seksionin 2.1 të këtij neni transferohen në një këst në një llogari bankare të veçantë të MFK-së dhe përdoren dhe menaxhohen në përputhje me udhëzimet e MCC-së, siç specifikohet më tej në nenin 8 të kësaj Marrëveshjeje. Kostot për menaxhimin fiskal dhe auditimin e Fondeve të Komunës dhe Fondeve të “ShP Te Gjykata” dhe “ShP Rilindja Jonë”.
- 2.3 Fondet e Komunës përdoren vetëm për qëllime të zbatimit të MEE në kuadër të AER IP (SEEK) për komplekset e zgjedhura në MAB, të specifikuara në seksionin 1.1 të kësaj Marrëveshjeje.
- 2.4 Brenda 15 ditëve nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje, Komuna, “ShP Te Gjykata” dhe “ShP Rilindja Jonë”, pas kërkesës me shkrim nga MFK-ja, i transferojnë Fondet në një llogari të specifikuar më poshtë (“Llogaria e Bashkëfinancimit”).

#### Fondet e Komunës

*Llogaria e bashkëfinancimit e MFK*

*Banka përfituese:*

TEB Sh.A., Prishtinë, Kosovë

*Kodi Swift/BIC:*

TEBKXKPR

*Emri i Përfituesit:*

FONDACIONI I MIJËVJEÇARIT I KOSOVËS

*Llogaria e përfituesit:*

EUR: 20-11-0001951853-80

*Adresa e Përfituesit:*

Rr. Migjeni Nr.21

Kati 9, ish-Banka e Lubjanës PRISHTINË 10000

### **NENI 3**

#### **Zbatimi dhe administrimi**

- 3.1 Palët e kuptojnë që Marrëveshja e Grantit të Programit Threshold është ratifikuar nga Republika e Kosovës, prandaj përbën një marrëveshje ndërkombëtare dhe zëvendëson rregullat dhe procedurat vendore. Çdo bashkëfinancim, në këtë rast, i ndjek rregullat që rrjedhin nga marrëveshja e tillë ndërkombëtare, siç zbatohet nga MFK.
- 3.2 Zbatimi i MEE në kuadër të AER IP për komplekset e zgjedhura të MAB që do të financohen sipas kësaj Marrëveshje fillon me kontraktimin e kompanive ndërtimore. Prokurimi i të gjitha mallrave dhe shërbimeve me fondet e përbashkëta të MFK, Komunës dhe ShP kryhet në përputhje me Udhëzimet e Programit MCC për Prokurimin<sup>2</sup> të datës prill 2020, të ndryshuara herë pas here.
- 3.3 Administrimi i Fondeve të Komunës bëhet në përputhje me politikat dhe procedurat e zbatueshme të MFK-së. MFK bënë të gjitha përpjekjet për të siguruar zbatimin me kohë dhe të plotë të MEE në kuadër të AER IP për komplekset përzgjedhura. MFK e informon Komunën me shkrim për çdo ndryshim në periudhën e pritshme të zbatimit.
- 3.4 Komuna dhe ShP pajtohen dhe pranojnë që në rast të moskompletimit të Punëve Ndërtimore dhe aktiviteteve tjera të parashikuara në këtë Marrëveshje deri në përfundim të Programit të Pragut në 30 shtator 2022, MFK do t'ia bartë përgjegjësinë Komunës për punët e mbetura, duke përfshirë edhe mbikëqyrjen e kontraktorëve në mënyrë që të sigurohet përfundimi i suksesshëm i gjithë nënprojektit, duke e përjashtuar Komunën nga ndonjë obligim tjetër financiar jashtë shumës së cekur në Shtojcën 1.

### **NENI 4**

#### **Planet arkitektonike dhe të dizajnit**

- 4.1 Palët dakordohen që zbatimi i punimeve për MAB e përzgjedhura bazohet në Planin e Detajuar Arkitektonik dhe Inxhinierik (DAED), të përgatitur nga Kompania për Projektim dhe Mbikëqyrje (DSC), e kontraktuar nga IC në bazë të aktivitetit PIEE.
- 4.2 Komuna siguron lejet e nevojshme ndërtimore si çështje me prioritet të lartë dhe në kohën më të shkurtër të mundshme, ose konfirmon që rinovimet që synojnë mirëmbajtjen e investimeve të të gjitha MAB-ve të përzgjedhura sipas kësaj Marrëveshjeje janë përjashtuar nga lejet e lidhura me ndërtimin.

### **NENI 5**

#### **Punimet ndërtimore**

- 5.1 Kompanitë e ndërtimit që ofrojnë mallra dhe shërbime për zbatimin e nënprojekteve tashmë janë kontraktuar nga MFK.
- 5.2 Palët pajtohen që DSC, e nënkontraktuar nga IC në kuadër të projektit PIEE, është autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e punimeve.

---

<sup>2</sup> Udhëzimet e Programit MCC për Prokurimin, të datës 2 prill 2020  
<https://assets.mcc.gov/content/uploads/guidance-2020001236803-procuction-program.pdf>

- 5.3 DSC-ja siguron një mbikëqyrje gjithëpërfshirëse të aktiviteteve të zbatimit të projektit të kryera nga kompanitë e ndërtimit për të siguruar pajtueshmëri me dokumentet e dizajnit (DAED), AER OM, detyrimet kontraktuale sipas kontratës së MFK si dhe ligjet dhe rregulloret e zbatueshme mjedisore në Kosovë.

## **NENI 6**

### **Përfundimi i aktiviteteve dhe lëshimi i faturave**

- 6.1 DSC në kuadër të projektit të PIEE është autoriteti përgjegjës për inspektimin, testimin, verifikimin dhe aprovimin përfundimtar të të gjitha fazave të ndërtimit (d.m.th., aktivitetet) të përshkruara në PPN (Plani i Punimeve Ndërtimore) i përgatitur dhe zbatuar nga kompanitë e ndërtimit. Çdo aktivitet i përshkruar në PPN konsiderohet i përfunduar vetëm pasi që DSC-ja të kontrollojë, miratojë dhe nënshkruaj Protokollin e Fazës së Ndërtimit (PFN), i përbërë nga listat përkatëse kontrolluese, regjistrat, raportet dhe certifikata e pagesës.
- 6.2 PFN-ja e përfunduar dhe e aprovuar është parakusht për lëshimin e Certifikatave të Pagesës (CP) për MFK-në që rezulton në ekzekutimin e pagesës të kompania e ndërtimit.
- 6.3 Kompania e ndërtimit ia lëshon CP MFK-së pas miratimit dhe nënshkrimit nga DSC.
- 6.4 CP e financuara nga Fondet e Komunës përmbajnë edhe TVSH-në e aplikueshme.
- 6.5 MFK siguron një kopje origjinale të CP-ve për Komunën dhe ShP.

## **NENI 7**

### **Aktivitetet e ndërsjella**

- 7.1 Palët planifikojnë t'i ndjekin aktivitetet e mëposhtme për ta rritur aftësinë e tyre për të bashkëpunuar:
- MFK, Komuna dhe ShP pritët të marrin pjesë në ceremoninë e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.
  - MFK, Komuna dhe ShP synojnë të ofrojnë ndihmën e nevojshme, duke përfshirë ndarjen e çdo informacioni që është jetik për zbatimin e aktiviteteve të nënprojektit të AER.
  - MFK, Komuna dhe ShP synojnë të angazhohen në mënyrë proaktive në aktivitetet e përbashkëta të nënprojekteve të AER dhe të monitorojnë zbatimin e aktiviteteve si dhe të bashkëpunojnë në identifikimin e zgjidhjeve në rast rreziku të dështimit të aktiviteteve.
  - MFK, Komuna dhe ShP pajtohen që të bashkëpunojnë dhe të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar zbatimin e suksesshëm të aktiviteteve të nënprojektit, për të parandaluar faktorët e mundshëm të rrezikut të cilët mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e nënprojektit dhe aktivitetet e tij.
  - Palët ndjekin Manualin Operativ të AER, të aprovuar nga MFK sipas projektit SEEK.

## **NENI 8**

### **Shqyrtimi, raportimi dhe auditimi**

- 8.1 Raportimi: MFK, në përputhje me procedurat standarde të raportimit dhe në përputhje me Parimet e Kostos të MCC dhe Planit të MFK për Llogaridhënie Fiskale, i ofron Komunës raporte mbi zbatimin e MEE në kuadër AER IP (SEEK) për komplekset e zgjedhura të MAB, të bashkëfinancuar sipas kësaj

Marrëveshjeje, dhe raporte dhe informacione të tjera të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme nga Komuna në lidhje me progresin e zbatimit të nënprojektit AER IP.

- 8.2 MFK e informon Komunën menjëherë për çdo kusht që: i) mund të shkaktojë vonesë të konsiderueshme në zbatimin e nënprojektit të AER IP; ii) ndërhyr në mënyrë të konsiderueshme ose rrezikon të ndërhyjë në përmbushjen e zotimeve nga MFK sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe iii) apo do të mund të ndikojë ndjeshëm në zbatimin ose ndikon në nënprojektet e AER IP.
- 8.3 MFK-ja prodhon raporte të rregullta financiare për Fondet e administruara sipas kësaj Marrëveshjeje në përputhje me procedurat standarde të raportimit që rregullohen nga Parimet e Kostos së MCC-së për Operacionet e Subjektit të Përgjegjshëm<sup>3</sup> dhe Planin e Përgjegjësisë Fiskale të MFK-së. Këto raporte mund t'i ofrohen Komunës, me kërkesën e tyre. Pas përfundimit të MEE në kuadër të nënprojektit AER IP, MFK-ja i ofron Komunës një raport përfundimtar të zbatimit, duke përfshirë të gjithë raportimin e detyrueshëm financiar.
- 8.4 Raportet e Auditimit: Fondet e Komunës auditohen nga auditori i pavarur publik i MFK-së në përputhje me Udhëzimet për Subjektet e Përgjegjshme të MCC-së për Auditimet Financiare të Kontraktuara.<sup>4</sup>

## NENI 9

### Dispozita të veçanta

- 9.1 Politika Kundër-Korrupsionit. Palët dakordohen që Fondet e Komunës udhëhiqen nga të njëjtat politika të zbatueshme për Financimin e Grantit të MCC-së, të cilat, ndër të tjera, i nënshtrohen Politikës së MCC-së për Parandalimin, Zbulimin dhe Zbutjen e Mashtrimit dhe Korrupsionit<sup>5</sup> ("Politika Kundër-Korrupsionit e MCC") në Operacionet e MCC. Politika Kundër-Korrupsionit e MCC kërkon që staf, pranuesit e Grantit të MCC-së, përfutuesit, këshilltarët, ofertuesit, furnizuesit dhe kontraktorët e përfshirë në Grantin e MCC-së ose ndonjë aktivitet të financuar nga Granti i MCC-së t'i respektojnë standardet më të larta të etikës dhe integritetit personal. Çdo palë që shkel Politikën Kundër-Korrupsionit të MCC-së mund t'i nënshtrohet sanksioneve dhe veprimeve të tjera korrigjuese. Çdo person juridik ose individ i përjashtuar ose i përjashtuar tërthorazi në përputhje me Politikën dhe Udhëzimet e MCC-së nuk ka të drejtë të marrë pjesë në aktivitete të financuara ose të mbështetura tërësisht ose pjesërisht nga financimi i Grantit të MCC-së.
- 9.2 Pajtueshmëria me Standardet e Performancës Mjedisore dhe Sociale. Zbatimi i MEE nën AER IP për komplekset e zgjedhura MAB të financuara nga kjo Marrëveshje realizohet në përputhje me Udhëzimet Mjedisore të MCC, Standardet e Performancës të Korporatës Financiare Ndërkombëtare ("IFC") dhe Legjislacionin Mjedisor dhe Social të Qeverisë së Kosovës.

<sup>3</sup>Parimet e Kostos së MCC-së për Operacionet e Subjektet Llogaridhënësë  
<https://www.mcc.gov/resources/doc/cost-principles-for-acteable-entity-operations>

<sup>4</sup>Udhëzime për Auditimet Financiare të Kontraktuara nga Subjektet Llogaridhënësë të Korporatës së Sfidave së Mijëvjeçarit  
<https://assets.mcc.gov/content/uploads/guidance-2020001234101-guidelines-for-contracted-audits.pdf>

<sup>5</sup>Politika e MCC-së për Parandalimin, Zbulimin dhe Zbutjen e Mashtrimit dhe Korrupsionit e datës 18 janar 2018  
Politika për Parandalimin, Zbulimin dhe Zbutjen e Mashtrimit dhe Korrupsionit në Operacionet e MCC-së

- 9.3 Pajtuëshmëria me Kërkesat Gjimore dhe Sociale. Zbatimi i MEE nën AER IP për komplekset e zgjedhura MAB të bashkëfinancuar sipas kësaj Marrëveshjeje janë në përputhje me Politikën Gjimore të MCC dhe Planin e Integritimit Social dhe Gjimore të MFK ("SGIP").
- 9.4 Publiciteti. MFK bënë përpjekje që t'i maksimizojë mundësitë për të nxjerrë në pah identitetin e kontributit të Komunës në AER IP, d.m.th., përmes sinjalistikës përkatëse, dokumentacionit dhe informimit të publikut në lidhje me AER IP, duke përfshirë përdorimin e logos së Komunës.

## **NENI 10**

### **Përfundimi dhe efektet e përfundimit**

10.1 Kjo Marrëveshje mund të përfundojë nën arsyt e mëposhtme:

- a) Nëse Komuna dështon në përmbushjen e ndonjëres nga detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje dhe dështimi i tillë vazhdon për 30 ditë pasi MFK të njoftoj Komunën për dështimin;
- b) Nëse "ShP Te Gjykata" dhe "ShP Rilindja Jonë" dështojnë në përmbushjen e ndonjëres nga detyrimet e tyre sipas kësaj Marrëveshjeje dhe dështimi i tillë vazhdon për 30 ditë pasi MFK të njoftoj Komunën për dështimin;
- c) Nëse, sipas kushteve të saj, skadon Marrëveshja e Grantit të Programit Threshold, ose ndodh ndonjë ngjarje që lejon përfundimin e Marrëveshjes së Grantit të Programit Threshold.

10.2 Pas përfundimit të hershëm të Marrëveshjes së Grantit të Programit Threshold, Palët bashkëpunojnë për t'i mbyllur të gjitha çështjet në lidhje me këtë Marrëveshje në përputhje me procedurat që përcaktohen nga Palët e kësaj Marrëveshjeje.

10.3 Në rast të përfundimit të parakohshëm të Marrëveshjes së Grantit të Programit Threshold para përdorimit të Fondeve të Komunës, MFK ia kthen fondet e tilla Komunës brenda 30 ditësh.

## **NENI 12**

### **Komunikimet dhe njoftimet**

11.1 Përfaqësuesit e autorizuar të MFK-së, Komunës dhe ShP bien dakord të takohen në mënyrë periodike për të diskutuar statusin e aktiviteteve të përmendura në këtë Marrëveshje dhe për ta forcuar efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e AER IP.

11.2 Për të gjitha qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, MFK, Komuna dhe ShP përfaqësohen nga personat që mbajnë ose veprojnë në pozitat e mëposhtme:

Për MFK:

Petrit Selimi

Kryeshef Ekzekutiv

Adresa: Rruga Migjeni Nr. 21

Për Komunën e Gjakovës:

Ardian Gjini

Kryetar i Gjakovës

Adresa: Rruga Nëna Terezë

Kati 9 i ndërtesës së ish-Bankës së Lubjanës  
10000 Prishtinë, Kosovë  
Email: petrit@millenniumkosovo.org  
Tel: +383 49 507521

5000 Gjakovë, Kosovë  
Email: ardian.gjini@rks-gov.net  
Tel: +383 390 321 100

Për ShP "Te Gjykata 1":  
Emri: Shpend Kadrija  
Pozita: Përfaqësues i Autorizuar  
Tel: +383 44 187 959

Për ShP "Te Gjykata 2":  
Emri: Lulzim Nagavci  
Pozita: Përfaqësues i Autorizuar  
Tel: +383 44 907 011

Për "ShP Rilindja Jonë 1":  
Emri: Astrit Hima  
Pozita: Përfaqësues i Autorizuar  
Tel: +383 44 387 675

Për "ShP Rilindja Jonë 2":  
Emri: Vllaznim Kozniku  
Pozita: Përfaqësues i Autorizuar  
Tel: +383 44 236 951

- 11.3 Secila Palë e kësaj Marrëveshjeje mund të propozojë përfaqësues shtesë të autorizuar për përfaqësimin e asaj Pale për të gjitha qëllimet, përveç për ekzekutimin e ndryshimeve në këtë Marrëveshje. Secila palë e njofton me shkrim Palën tjetër për ndryshimet në lidhje me përfaqësimin e autorizuar në këtë Marrëveshje.

### **NENI 13** **Të ndryshme**

- 12.1 Caktimi. Komuna dhe ShP nuk mund t'i caktojnë, delegojnë ose ndryshe transferojnë të drejtat ose detyrimet e tyre sipas kësaj Marrëveshjeje pa pëlqimin paraprak me shkrim të MFK-së.
- 12.2 Ligji rregullues. Ligjet e Republikës së Kosovës rregullojnë vlefshmërinë, interpretimin dhe performancën e kësaj Marrëveshjeje dhe gjykatat e Republikës së Kosovës kanë juridiksion ekskluziv.
- 12.3 Gjuha. Kjo Marrëveshje është përgatitur në gjuhën angleze dhe shqipe. Në rast paqartësie ose konflikti midis versioneve, versioni në gjuhën angleze i kësaj Marrëveshjeje mbizotëron.
- 12.4 Vlefshmëria e pjesshme (severabiliteti). Pavlefshmëria, paligjshmëria ose pazbatueshmëria e ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje nuk ndikojnë në vlefshmërinë, ligjshmërinë dhe zbatueshmërinë e dispozitave të mbetura të kësaj Marrëveshjeje.
- 12.5 Mos heqja dorë. Dështimi i cilësdo Palë që të kërkoj zbatimin strikt të ndonjë dispozite të kësaj Marrëveshjeje apo për të ushtruar ndonjë të drejtë, kompetencë ose korrigjim si pasojë e një shkelje të kësaj Marrëveshjeje, nuk përbënë heqje dorë nga Pala e tillë për të kërkuar pajtueshmëri të rreptë dhe të përpiktë me secilën nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

- 12.6 Marrëveshja në tërësi dhe ndryshimi. Kjo Marrëveshje përbënë të gjithë marrëveshjen mes Palëve. Asnjë ndryshim i ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje nuk ka ndonjë forcë ose efekt, përveç nëse është bërë me shkrim dhe është nënshkruar nga të dyja Palët. Asnjë heqje dorë nga ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje nuk ka ndonjë forcë ose efekt, përveç nëse është bërë me shkrim dhe është nënshkruar Pala kundër së cilës kërkohet zbatimi.
- 12.7 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve. Palët bien dakord të zgjidhin miqësisht çdo mosmarrëveshje që lind në lidhje me këtë Marrëveshje. Në rast të një mosmarrëveshjeje, Palët në këtë Marrëveshje marrin përsipër për njëzet (20) ditë nga dita e pranimit të njoftimit zyrtar nga pala tjetër të negociojnë në mirëbesim për zgjidhjen e mosmarrëveshjes sipas pritjeve të të dyja palëve.
- 12.8 Arbitrazhi. Çdo mosmarrëveshje, polemikë ose pretendim që lind ose ka të bëjë me këtë kontratë, ose shkelja, ndërprerja ose pavlefshmëria e saj që nuk mund të zgjidhet në mënyrë miqësore nga Palët në këtë Marrëveshje, zgjidhet me arbitrazh në Qendrën e Arbitrazhit në Odën Ekonomike Amerikane në Kosovë, në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit të Qendrës së Arbitrazhit në Odën Ekonomike Amerikane.

#### NENI 14

#### Fillimi dhe ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje

- 13.1 Kjo Marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin e gjitha Palëve ("Data e Hyrjes në Fuqi") dhe mbetet në fuqi dhe efekt të plotë deri në datën 30 shtator 2022.
- 13.2 Ndryshimet në këtë Marrëveshje bëhen vetëm me kërkesë me shkrim nga cilado Palë dhe mund të hyjnë në fuqi pas marrëveshjes nga Palët.
- 14 **NË DËSHMI TË KËSAJ**, MFK, Komuna dhe "ShP Te Gjykata" dhe "ShP Rilindja Jonë", secila duke vepruar përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar siç duhet, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në gjashtë kopje origjinale në gjuhën angleze dhe shqipe më 8 qershor 2022.

**Për Fondacionin e Mijëvjeçarit në Kosovë:**

Petrit Selimi

Kryeshefi Ekzekutiv



**Për ShP Te Gjykata 1**

Shpend Kadrija

Përfaqësues i Autorizuar

**Për Komunën e Gjakovës:**

Ardian Gjini

Kryetari i Komunës

**Për ShP Te Gjykata 2**

Lulzim Nagavci

Përfaqësues i Autorizuar

**Për ShP Rilindja Jonë**  
Astirë Himaj  
Përfatësues i Autorizuar

**Për ShP Rilindja Jonë 2**  
Vllaznim Kozniku  
Përfatësues i Autorizuar

**SHTOJCA I**  
**Plani i Financimit**

Ky Plan i Financimit përfaqëson marrëveshjet e arritura financiare ndërmjet Palëve për bashkëfinancimin e riparimit për EE të MAB Kompleksit “ShP Te Gjykata” dhe “ShP Rilindja Jonë” në Gjakovë, bazuar në ofertën financiare të pranuar nga kompanitë e zgjedhura të ndërtimit përmes procedurës së prokurimit të zbatuar nga MFK.

Shumat përfundimtare të bashkëfinancimit për MFK-në, Komunën dhe ShP janë treguar në Tabelën I në vijim.

| Tabela I: Kostoja përfundimtare për zbatimin e masave të EE në komplekset MAB në Gjakovë | MEE-të              | Kostoja totale (pa TVSH) |             |              | Ndarja e grantit (pa TVSH) |                  |                  | KOSTOJA TOTALE E INVESTIMEVE |  |  |
|------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------|--------------------------|-------------|--------------|----------------------------|------------------|------------------|------------------------------|--|--|
|                                                                                          |                     | Komuna<br>30%            | ShP<br>10%  | MFK<br>60%   | Komuna (me<br>TVSH)        | ShP<br>(me TVSH) | MFK<br>(pa TVSH) |                              |  |  |
| MAB Kompleksi "Te Gjykata"                                                               | € 308,604.56        | € 92,581.37              | € 30,860.46 | € 185,162.74 | € 109,246.01               | € 36,415.34      | € 185,162.74     |                              |  |  |
| MAB Kompleksi "Rilindja Jonë"                                                            | € 209,724.50        | € 62,917.35              | € 20,972.45 | € 125,834.70 | € 74,242.47                | € 24,747.49      | € 125,834.70     |                              |  |  |
| <b>TOTAL</b>                                                                             | <b>€ 518,329.06</b> | € 155,498.72             | € 51,832.91 | € 310,997.44 | € 183,488.49               | € 61,162.83      | € 310,997.44     | € 555,648.75                 |  |  |



Date: 8 June 2022

## Apartment Building Energy Retrofits (AER)

on

the Home-Owners' Association (HoA) of MAB "Rilindja Jonë",

the Home-Owners' Association (HoA) of MAB "Te Gjykata",

and

the Municipality of Gjakova

and


Millennium Foundation Kosovo,

between

## Co-funding Agreement



**MILLENNIUM  
FOUNDATION  
KOSOVO**



This Co-funding Agreement is entered into by and between:

1. **Millennium Foundation Kosovo** ("MFK"), a local foundation organized and registered pursuant to the Millennium Challenge Account Threshold Program Grant Agreement signed and ratified on September 12, 2017, between the Republic of Kosovo, acting through the President of the Republic of Kosovo (the "Government"), and the United States of America, acting through the Millennium Challenge Corporation ("MCC");
2. **The Municipality of Gjakova** ("the Municipality");
3. **Home-Owners' Association (HoA) of MAB "Te Gjykata" ("HoA Gjykata")**;
4. **Home-Owners' Association (HoA) of MAB "Rilindja Jone" ("HoA Rilindja Jone")**;

The following are referred to separately as "MFK", "the Municipality", "HoA Te Gjykata" and "HoA Rilindja Jone", respectively, and jointly referred to as "the Parties" in this Co-funding Agreement ("Agreement").

## 1. List of Acronyms

In this Agreement, the acronyms below have the following meanings:

**AER** - Apartment Building Energy Retrofits  
**AER OM** - AER Operation Manual  
**CWP** - Construction Work Plan  
**Contractor** - Construction Work company, selected by MFK through the tender procedure  
**CP** - Construction Phase  
**CPP** - Construction Phase Protocol  
**DAED** - Detailed Architectural and Engineering Design  
**DSC** - Design and Supervision Company  
**EE** - Energy efficiency  
**EEM** - Energy Efficiency Measures  
**FP** - Financial Plan  
**HoA** - Home Owners Association  
**IC** - Implementing Consultant of PIEB  
**MAB** - Multi-Family Apartment Building  
**MCC** - Millennium Challenge Corporation  
**MFK** - Millennium Foundation Kosovo  
**MoU** - Memorandum of Understanding  
**PC** - Payment Certificate  
**PIE** - The Pilot Incentives for Energy Efficiency  
**RELP** - Reliable Energy Landscape Project  
**RC** - Residents' Council  
